



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 54, datë 30.9.2017

**PËR RISHQYRTIM TË VKB NR. 50, DATË 6.9.2017 “PËR MIRATIM TË
VLERSIMIT PARAPRAK DHE MASA E SHPËRBLIMIT PËR SHPRONËSIMIN
PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE QË PREKEN PËR EFEKT TË INVESTIMIT PUBLIK TË
OBJEKTIT “NDËRTIM PARCELA TË REJA VARRESH”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 23 pika 7, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr. 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, shkresat nr. 3210/1 prot, datë 13.5.2017, nr. 5954/1 prot, datë 10.8.2017, të ZVRPP Shkodër, VKB nr. 48, datë 3.8.2017 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2016 të Bashkisë Shkodër”, VKB nr. 27, datë 20.4.2017 “Për miratimin e planit të zhvillimit të territorit dhe rregulloren e zbatimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Shkodër”, shkresës nr. 954/1 prot, datë 18.9.2007 të Prefektit të Qarkut Shkodër “Lidhur me vendimin nr. 50, datë 6.9.2017 të këshillit bashkiak Shkodër”, pas diskutimeve, me 35 vota pro,

V E N D O S I :

1. Të miratojë vlerën e shpronësimit tokë bujqësore (arë) për investime publike për objektin “Ndërtim parcela të reja varresh”, me vlerë **9.868.500** (nëntë milion tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, sipas pasqyrës bashkëngjitur.
2. Burimi i financimit në vlerën prej 9.868.500 lekë do të jetë Buxheti i Bashkisë Shkodër i vitit 2017, programi 6260 “shërbime publike vendore”, Artikulli 231 “shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.9.2017
Shpallur në datën 2.10.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pf. 15251 12.10.2017

Nr.1019/1 Prot

Shkodër, me 10.10.2017

Lënda: Lidhur me vendimin Nr.54 datë 30.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit Nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin", ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, pika 7, neni 54/dh, 55, pika 3, ligjit Nr.8561 date 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, ligji Nr. 9244 date 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqesore" i ndryshuar, neni 13 dhe 14, ligjit Nr.8752 datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, VKM Nr.410 datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", VKM Nr.127 datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njohimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", VKE nr. 27, datë 20.04.2017 "Për miratim plan zhvillimi e territorit", VKE nr. 8 datë 30.01.17 "Miratim buxheti 2017"-programi 3260 "shërbime publike", Art.231, analizozi vendimin e KB Shkodër Nr.54 datë 30.09.2017, rishqyrtim i VKE Nr.50 datë 6.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratim të vlerësimit paraprak dhe masa e shoërbimit për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken për efekt të investimit publik të objektit "Ndërtim parcela të reja varreshi".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Me respekt:

